



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 48/2022 (JR)

Nr. 48/2 regj.

Tiranë, më 06.05.2025

SHPLLJE

E

NJOFTIMIT PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJES NË DHOMË KËSHILLIMI

Nëpërmjet kësaj shpalljeje, Kolegji i Posaçëm i Apelit, bazuar në nenin 65, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, njofton subjektet e procesit, si dhe të gjithë personat e interesuar, se ditën e mërkurë, **datë 28.05.2025, ora 10:00**, do të shqyrtohet në dhomë këshillimi mbi bazë dokumentesh, çështja me nr. regjistri (JR) 48/2022, datë 17.11.2022, për ankimin e subjektit të rivlerësimit, z. Emiljano Ruli kundër vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 557, datë 29.07.2022.

Seanca gjyqësore në dhomë këshillimi do të zhvillohet në selinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në adresën: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit” nr. 3, Tiranë.

Trupi Gjyqësor, përbëhet nga gjyqtarët:

Kryesuese e Trupit Gjyqësor

Relatore e Çështjes

Gjyqtare

Gjyqtare

Gjyqtar

Rezarta Schuetz

Albana Shtylla

Natasha Mulaj

Mimoza Tasi

Sokol Çomo

Bazuar në nenin 49, pika 2 e ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, palët kanë të drejtë të paraqesin deri 5 ditë para seancës së shqyrtimit të çështjes, parashtrime me shkrim, lidhur me shkaqet e ngritura në ankim.

Bazuar në nenin 482, paragrafi i tretë i Kodit të Procedurës Civile, kjo shpallje bëhet të paktën 15 ditë përpara datës së shqyrtimit, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, si dhe me njoftim individual në adresën elektronike alternative të subjektit të rivlerësimit. Ky njoftim bëhet gjithashtu edhe në faqen e internetit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

KRYESUESE E TRUPIT GJYKËS

GJYQTARE

REZARTA SCHUETZ

